LIBËRTHI I PËRGJEGJËSISË SOCIALE

'19

BALFIN
Balkan Finance Investment Group

KY ËSHTË NJË BOTIM
I GRUPIT BALFIN

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, shpërndahet, ose transmetohet në çfarëdo forme apo mënyre, duke përfshirë fotokopjimin, regjistrimin, ose metoda të tjera elektronike, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

PËRMBAJTJA

Kontribut për familjet e dëmtuara nga tërmeti 06

Nismat vullnetare të punonjësve 08

Për edukimin 12

Për fëmijët 16

Për familjet në nevojë 20

Aktivitete të tjera 21

1 MILIONË EURO PËR INVESTIME SOCIALE

Grupi Balfin është i vendosur në promovimin e vlerave më të larta shoqërore, duke u përkujdesur për komunitetin dhe ambientin. Ne përpiqemi që bizneset tona të ndikojnë në përmirësimin e standardeve dhe kushteve të punës, infrastrukturës, kujdesit shëndetësor, edukimit dhe kulturës.

Shoqëritë e Grupit Balfin nuk ofrojnë vetëm punësim dhe zhvillimin ekonomik të komunitetet ku janë të pranishme por bëhen pjesë e komuniteteve dhe nëpërmjet investimeve sociale ndihmojnë në përmirësimin e jetesës. Përgjatë vitit 2019, me nismën dhe përkujdesjen e veçantë të Presidentit të Grupit Balfin, Samir Mane, Grupi dhuroi rreth 1 milionë euro për organizimin e një numri të madh investimesh sociale, duke dhënë kontribut të çmuar për arsimin, fëmijët, shëndetësinë, mjedisin, artin, etj.

NE BESOJMË **SE RRITJA E NJË BIZNESI**
DUHET TË SHOQËROHET PARALELISHT **ME ZHVILLIMIN**
DHE RRITJEN EKONOMIKE DHE SOCIALE
TË KOMUNITETIT KU AI VEPRON

Grupi Balfin i është bashkuar Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Këto objektiva synojnë një shoqëri më të mirë dhe zhvillim në të gjithë botën. Projektet e përgjegjshmërisë sociale të Grupit Balfin janë fokusuar në disa prej Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm si:

OBJEKTIVI#01
Eliminimi i varfërisë në të gjitha format kudo.

OBJEKTIVI#02
Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimit të ushqyerjes dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme.

OBJEKTIVI#03
Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe.

OBJEKTIVI#04
Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të drejtë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë.

OBJEKTIVI#08
Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë.

OBJEKTIVI#09
Ndërtimi i infrastrukturave rezistuese, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit.

OBJEKTIVI#10
Zvogëlimi i pabarazisë brendapërbrenda vendeve dhe mes tyre.

OBJEKTIVI#17
Fuqizimi i mjeteve të vënies në zbatim dhe rigjallërimi i partneritetit botëror për zhvillim të qëndrueshëm.

KONTRIBUT PËR FAMILJET E DËMTUARA NGA TËRMETI

Tërmetit që preku vendin tonë në nëntor të vitit 2019 rezultoi me humbje të rënda në njerëz dhe materiale duke prekur thuajse të gjithë shoqërinë shqiptare. Si një pjesë vitale e saj, Grupi Balfin u bë pjesë e planit të zgjidhjes dhe lehtësimit të kësaj dhimbjeje.

Grupi Balfin vendosi që të dhurojë për familjet e prekura nga tërmeti rreth 1.2 milion euro. Nga ky fond, deri në fund te vitit 2019, u disbursuan rreth 480,000 euro, si dhurime, para në dorë apo ndihma materiale.

1'2

MILIONË **EURO**

PËR FAMILJET E PREKURA NGA TËRMETI

Shoqëritë Neptun Maqedonia, Neptun Kosova, QTU, TEG, Jumbo, Spar Albania dhe Tirana Bank u bashkuan në këtë nisëm të përbashkët

NISMAT VULLNETARE TË PUNONJËSVE

Përgjatë vitit 2019, mbi 2,000 punonjës të Grupit Balfin kanë organizuar nisma vullnetare duke ndihmuar në fusha dhe kategori të ndryshme sociale si: **fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, fëmijët jetimë, fëmijët dhe të rinjtë me sindromën down, fëmijët me çrregullime të spektrit autik, viktimat e dhunës në familje, familjet në nevojë, të moshuarit, mbrojtja e mjedisit, etj.**



KUJDESU
PËR
NATYRËN!
SIGURO TË
ARDHMEN!
FOR THIS
EARTH WE
ADORE,
LET'S ALL
DO MORE

2’000

PUNONJËS

JANË ANGAZHUAR
NË NISMA VULLNETARE

PËR EDUKIMIN

Grupi Balfin financoi ndërtimin e **një laboratori të ri informatike** për studentët e Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Tiranës. Ky laborator ju shërben çdo ditë mijëra studentëve të këtij Fakulteti.

AlbChrome financoi me një vlerë prej 5,000 Euro për ndërtimin e laboratorit të Informatikës për rreth **350 nxënësit** e gjimnazit "28 Nëntori" në Burrel.

Për të dytin vit rradhazi, Green Coast ka dhënë **bursë studimi** për studentët më të mirë të degës Master në Menaxhim Turizmi, Universiteti i Tiranës. Kjo nismë tashmë është kthyer në një traditë e Green Coast dhe njëkohësisht një mbështetje për turizmin kombëtar dhe zhvillimit të kapaciteteve njerëzore.

Në bashkëpunimin me Swiss Contact, Grupi Balfin vijon t'i ofrojë nxënësve të shkollave profesionale mundësinë e kryerjes së praktikave mësimore në shoqëritë e Grupit.

Grupi Balfin mbështeti financiarisht Konkursin Kombëtar "Sipërmarrësit dhe Juristët e së Nesërmes", të organizuar nga Tirana Business University, ku në fund u shpallën dhe fituesit për çdo kategori.

AlbChrome vijon të mbështesët financiarisht **dy shkollat e Mesme Profesionale në Elbasan dhe Bulqizë**, duke u kujdesur që ti furnizojë këto institucione arsimore me bazë materiale, si edhe duke mundësuar një pjesë të pagave të stafit akademik. Me dhjetra nxënës të këtyre shkollave, ndjekin çdo vit praktikat profesionale në Minierën e Kromit në Bulqizë apo në Uzinën e Ferrokromit në Elbasan, si dhe punësohen nga AlbChrome pas përfundimit të studimeve si elektriçistë apo teknikë të mesëm.

Grupi Balfin vlerëson shumë potencialin dhe fuqinë e patjetërsueshme që dija dhe leximi kanë për zhvillimin dhe emancipimin e shoqërisë shqiptare. Fale kontributit të Grupit, Biblioteka e rrethit Mat u pasurua këtë vit me mbi **2,500 tituj të rinj librash.**

Qendra Tregtare Univers – QTU, në partneritet me Junior Achievement Albania, kontribuoi në organizimin e Panairit të Sipërmarrjes, ku morën pjesë mbi **130 maturantë** të shkollave të mesme të vendit.

PËR FËMIJËT

Një fond prej 10,000 Euro u dhurua nga kompania AbChrome duke përgatitur dhurata të personalizuara për **70 nxënës** të shkollës "Xhevdet Doda" në Bulqizë.

AlbChrome i erdhi në ndihmë me bazë materiale Çerdhes nr. 2 të Burrelit, duke kontribuar me një vlerë prej 3,000 Euro në përmirësimin e kushteve për **35 foshnjët** që rriten aty çdo ditë

Grupi Balfin mbuloi financiarisht me një vlerë prej **15,000 Euro** shërbimet spitalore dhe trajtimet mjekësore për tre të rinj me probleme shëndetësore.

Falë mbështetjes së Grupit Balfin, programi Tungjatjeta arriti të përçojë jehonën në çdo cep të vendit duke gjeneruar kontribute të shumta, të cilat mundësuan trajtimet e nevojshme terapeutike për mbi **40 fëmijë me aftësi të kufizuara**.

AlbChrome mbështeti financiarisht me një vlerë prej 8,000 Euro programin social "Tungjatjeta" nga World Vision, nëpërmjet të cilit **8 fëmijë me aftësi të kufizuara** në Bulqizë morën shërbim të specializuar në shtëpi.

Spar Albania ka dhuruar 5 lekë, për çdo shishe uji Spar të blerë, për fëmijët me aftësi të kufizuara. Uji Spar është veshur me një etiketë të veçantë kushtuar ndërgjegjësimit për t'i qëndruar pranë fëmijëve me aftësi të kufizuara.



AlbChrome mundësoi krijimin e hapësirës zhvillimore në shkollën "Alush Lleshanaku" në Elbasan, si një model i ri i shërbimeve të integruara brenda shkollës. Donacioni prej 6,500 Euro mundësoi krijimin e kësaj hapësire zhvillimore, e cila ju shërben mbi 380 nxënësve nëpërmjet shërbimeve të integruara psiko-sociale, zhvillimore, terapeutike për zhvillimin e fëmijëve, e kryesisht atyre me nevoja të veçanta.

Fashion Group Albania punësoi **dy të rinjtë e parë** me Sindromën Down.

50 lekë për çdo produkt Babylino të shitur në dyqanet Spar, u dhurua si donacion për qindra fëmijë në shtëpitë e femijës në gjithë vendin.

Në muajin dhjetor, Grupi Balfin mundësoi dhurata për **46 fëmijë** të policëve të vrarë, duke përcjellë mesazhin se askush prej tyre nuk është vetëm.

Grupi Balfin sponsorizoi "Ballon Vieneze", kontributet për të cilën shkuan si donacion për fëmijet e Spitalit Pediatrik në Tiranë.

Falë kontributit të Jumbo, Qendra Shëndetësore nr.7 në qytetin e Durrësit, ka tashmë ambiente më të ngrohta dhe miqësore të dedikuara për fëmijët.

Spar Albania mbështeti financiarisht pjesëmarrjen e ekipit shqiptar në Lojërat Botërore "Special Olympics".

Grupi Balfin, për të disatin vit radhazi ka uruar festat e fundvitit nëpërmjet kartolinave të përgatitura nga fëmijët e Fshatrave SOS. Vlera për blerjen e kartolinave shkoi si kontribut në ndihmë të këtyre fëmijëve.

Neptun dhuroi fondin prej **10,000 Euro**, mbledhur nga shitja e Kartave Happy, si kontribut financiar për organizatat "Down Syndrome Albania" dhe "Jonathan Center" për të ndihmuar në informimin, ndërgjegjësimin dhe përfaqësimin sa më të mirë të individëve me sindromën Down në Shqipëri.

PËR FAMILJET NË NEVOJË

Grupi Balfin nëpërmjet kompanive Mane TCI, Neptun Abania, AlbChrome dhe Tirana Bank, ka ndërtuar dhe mobiluar tërësisht **tri shtëpi të reja** për tre familje në varfëri ekstreme.

Spar Albania vijoi kontributin e përmuajshëm me ushqime për **15 familje në nevojë** në Tiranë, Lushnje, Delvinë, Klos, Burrel dhe Bulqizë. Çdo vit, Spar Albania vendos në dispozicion për pensione ushqimore një fond prej **30,000 Euro.**

Grupi Balfin vijon të jetë një mbështetës kryesor i aktiviteteve dhe shfaqjeve të Teatrit Kombëtar, nëpërmjet para-blerjes së një sasie të madhe biletash. Këto bileta i dhurohen punonjësve të shoqërive të Grupit.

AKTIVITETE TË TJERA

Në bashkëpunim me UNDP, Tirana Bank organizoi fushatën ndërgjegjësuese "Të gjithë për Tokën" dedikuar mbrojtjes së mjedisit, për të cilën u dedikua një fond prej **10,000 Euro.**



AlbChrome ka investuar gjatë vitit 2019 në përmirësimin e ngrohjes së Spitalit të Bulqizës.

Tirana Bank mbështeti me një vlerë prej **10,000 Euro** "Maratonën e Tiranës", duke promovuar jetesën e shëndetshme nëpërmjet sportit.

ADRESA:
RR. 'PAPA GJON PALI II',
ABA BUSINESS CENTER, KATI I 11-TË,
TIRANË, SHQIPËRI

BALFIN SOCIAL

info@balfin.al
www.balfin.al